

KËRKESË
Nr. 27, datë 5.2.2021

PËR SHPREHJE INTERESI PËR SHËRBIMIN E KONSULENCËS LOKALE
“KRIJIMI I NJË MEKANIZMI TË RI KONTROLLI DHE UDHËHEQEJE PËR
REFORMËN E AFTËSISË SË KUFIZUAR”

Tiranë, më 3.2.2021

Ref. no. SAMP/CS/CQ/03-2020

Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)

Hua nr.: 8841- AL

Nr. i identifikimit të projektit: P162079

Republika e Shqipërisë ka marrë një financim shtesë nga Banka Botërore, nëpërmjet kostos së Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP), dhe ka planifikuar të përdorë një pjesë të saj për shërbim konsulence. Shërbimi i konsulencës (shërbimi) së kërkuar është “Krijimi i një mekanizmi të ri kontrolli dhe udhëheqjeje për reformën e aftësisë së kufizuar”.

Shërbimet e konsulencës (shërbimet) përfshijnë:

- Përmirësimi i administrimit dhe transparencës së skemës së re të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, përmes krijimit të një mekanizmi të qartë referimi, i cili përcakton qartë nga kush, kujt, kur dhe çfarë afatesh ose cilit program mund t'i referohet në mënyrë specifike, pikave fokale dhe strukturave përgjegjëse, si dhe sistemin e tyre të monitorimit.

Termat e detajuara të referencës (TOR) për këtë shërbim janë bashkangjitur kësaj kërkesë për shprehje interesi.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet Ekipit të Menaxhimit të Projektit SAMP fton të gjitha kompanitë lokale të pranueshme (konsulentët) të shfaqin interesin e tyre në ofrimin e shërbimeve të kërkuara. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion ku të demonstrojnë se ata kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme për të kryer shërbimin e kërkuar.

Konsulentët e interesuar duhet të sigurojnë informacion që demonstroi se ata kanë kualifikimet e kërkuara dhe përvojën përkatëse si më poshtë:

- të paktën 5 vjet eksperiencë të provuar në fushën e zbatimit të projekteve të shërbimeve të mbrojtjes sociale dhe/ose programeve, aktiviteteve, me theks në programet e asistencës për aftësinë e kufizuar dhe programet e mbrojtjes sociale, si dhe zhvillimin procedural, institucional dhe shoqëror në përgjithësi (40 pikë);

- konsulenti duhet të japë përshkrimin e punës/detyrave/kontratës më të rëndësishme dhe të ngjashme, duke demonstruar aftësi të përshtatshme në aktivitetet e lartpërmendura në pesë vitet e fundit (emri i kontratës, kohëzgjatja, buxheti, burimi i financimit) (50 pikë);

- disponueshmëria e stafit kryesor brenda kompanisë (10 pikë).

Konsulentët e interesuar duhet të marrin në konsideratë politikën dhe klauzolat e Bankës Botërore, në lidhje me konfliktin e interesit, e përcaktuar kjo në seksionin III, paragrafët 3.14, 3.16 dhe 3.17 të “Rregullave të prokurimit të Bankës Botërore për huamarrësit e FPI-së”, të datës korrik 2016 (rregullat e prokurimit).

Konsulentët mund të shoqërohen me firma të tjera për të rritur kualifikimet e tyre, por duhet të tregojnë qartë nëse shoqata është në formën e një *joint venture* apo në formën e nënkontraktimit. Në

rastin e një *joint venture*, të gjithë partnerët në *joint venture* do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe individualisht për të tërë kontratën, në rast se përzgjidhen.

Një konsulent do të përzgjidhet në përputhje me metodën e “Përzgjedhjes bazuar në kualifikimet e konsulentit (CQS)”, të përcaktuar në rregullat e prokurimit.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme, gjatë orarit zyrtar 08:00–16:30 (e hënë deri të enjten) dhe 08:00–14:00 të premten.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi ose me *email*) deri më **22 shkurt 2021**.

Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT)

Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale – kati I

Rruga e Kavajës, nr. 53, AL - 1001, Tirana, Albania

Në vëmendje të znj. Suzana Papadhopulli

Email: samp.papadhopulli@gmail.com